

(VIDEO) Arrestohet 33-vjeçari me precedentë të theksuar kriminalë në Elbasan, i gjendet arsenal armësh

05 Qershor, 2020 10:43 |



Madhësia e tekstit:

ELBASAN

Policia e Elbasanit ka sekuestruar arsenal armësh dhe ka arrestuar një 33-vjeçar me precedentë të theksuar kriminalë në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe krimeve ndaj personit.

Në kuadër të zbatimit të planit të masave për kontrollin e personave me precedent dhe të dyshuar për armëmbajtje pa leje, bazuar edhe në informacionet e marra në rrugë operative, strukturat e DVP Elbasan, në bashkëpunim me Forcat Speciale RENE, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Shënkoll”.

Në kuadër të operacionit, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit Ervis Daka. 33 vjeç, banues në lagjen Shënkoll, Elbasan, Policia gjeti dhe sekuestroi një arsenal armësh, konkretisht: një kallashnikov, dy pistoleta (njëra prej tyre me silenciator), 170 fishekë dhe një jelek antiplumb.

Gjithashtu, në cilësinë e provës materiale u sekuestruan dy automjete dhe dy telefona celularë. Në përfundim të veprimeve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E. D., për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”. Materialet do t’i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprime të mëtejshme.


Arrestohet 33-vjeçari me precedentë të theksuar kriminalë në Elbasa...



Për t’u bërë pjesë e grupit “Balkanweb” mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: ARSENAL ARMESH Elbasan

TË NGJASHME




Operacioni “Domosdova”, sekuestrohen 28.5 kg drogë në Elbasan, arrestohen 3 korçarë, në kërkim një i katërt
05 Qershor, 2020




Sekuestrohet arsenal armësh zjarri në Gjirokastrë, pranga poseduesit 63 vjeçar
05 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (1)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



Dëshmia tronditëse e shqiptares për “përbindëshin e Kavos”: “Ai abuzoi me mua, më bëri video dhe kërcënoi të më vriste”
07 Qershor, 2020



Ekzekutimi i vëllezërve Bardhi në Krujë, kushëriri i Roland Pulës tregon dinamikën e ngjarjes: Viktimat i thanë ‘ku jeni ju trimat, të hani m...’
07 Qershor, 2020




EMRI + FOTO/ Grabiste italianët, arrestohet shqiptari dhe bashkëpunëtori
07 Qershor, 2020



EMRAT/ Qëlloi për vdekje bashkëkombasin në një bar në Itali, 12 vjet burg për vrasësin e kapur në Tiranë
07 Qershor, 2020



Mediat italiane: Bilokohet gomonia me 3 kuintalë drogë në Lece, arrestohen kontrabandistët shqiptarë
07 Qershor, 2020




Ushtronte aktivitetin e paligjshëm të lojërave të fatit në Korçë, në kërkim pronari, arrestohet punëtori i tij
07 Qershor, 2020

KATEGORIA VIDEO




“Boll e goditët, o Zot, ndaloni”/ Del videoja e një tjetër afro amerikani të vrarë nga policia në SHBA
07 Qershor, 2020




(Video) Parashikimi i motit, 7 qershor 2020
07 Qershor, 2020




(Video)Meta mesazh për ‘Zgjedhoren’: Marrëveshja, hap i rëndësishëm! Do të kishte pasoja të rënda, nëse reforma do të ishte e njëanshme
07 Qershor, 2020



FOTO/ Lihet në burg 37-vjeçari i arrestuar nga RENE në Kamëz, avokati: U hiperbolizua ngjarja, Kryemadhit iu gjet në banesë vetëm një thikë
07 Qershor, 2020



(Video)Protesta për vdekjen e George Floyd, 5-vjeçarja afro amerikane i drejtohet policit: Do të më qëllosh? Ja si reagon ai
07 Qershor, 2020



(VIDEO)Digjet banesa në Prrenjas, shpëtojnë familjarët dhe e moshuara në gjumë
06 Qershor, 2020